

Turgut Özal

BULETIN



EDITORIAL

Numri më i ri i buletinit të shkollës “Turgut Özal” pasqyron aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës shtator-dhjetor të këtij viti shkollor. Në të do të gjeni një sërë veprimtarish, vizitash e ekskursioneve që kanë pasuruar ditët e nxënësve gjatë këtyre muajve.

Një vend të veçantë zënë takimet me personalitete të rëndësishme në vend apo vizitat që janë zhvilluar në institucione të ndryshme të pushtetit qendror dhe lokal, muzeume dhe objekte historike.

Provimet e përgjithshme, konkurset kombëtare, olimpiadat apo udhëtimet brenda e jashtë vendit kanë marrë hapësirën e tyre në këtë buletin.

Nuk mungojnë klubet, të cilët e kanë vazhduar veprimtarinë e tyre jashtëshkollore duke u shtuar këtë vit me disa klube të reja dhe mjaft të ndjekura nga nxënësit.

Aktivitetet e para-shkollorit gjithashtu kanë vendin e tyre në këtë buletin duke na transmetuar më së miri veprimtaritë e vogëlushëve 3-6 vjeç.

Vend të veçantë zënë aktivitetet sportive, të cilat kanë përfshirë brenda tyre një numër të madh nxënësish nga të gjitha paralelet. Duke patur parasysh se një edukim vetëm brenda mureve të klasës nuk është asnjëherë i plotë, mund të themi se gjatë këtyre muajve nxënësit kanë mësuar shumë nga aktivitetet jashtëshkollore, të cilat do t'i gjeni të ilustruara në faqet e këtij buletini.

Klubi i Medias:

Mësues

Erjon Saliasi

Erjona Saqe

Imelda Prençe

Elda Rrustemi

Irma Derjaj

Nxënës

Engjëllushe Basha

Enisa Dalipi

Breana Shehetila

Gea Ivanaj

Vivien Shkodra

Xhoia Mekollari

Fotograf

Lulëzim Marra

Dizajn:

Dorjan Pitani

ADRESA

Rruga “Bernardin Palja”

Ndërtesa 15, Hyrja 1

Njësia Bashkiake Nr.6

Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666

FAX: +355 42 486-666

info@turgutozal.edu.al

TURGUT ÖZAL

19

TIRANË

PËRMBAJTJA

1. Klubi Shpresa
2. Panairi ushqimor
3. Veprimtari të Klubit Shpresa
4. Në Bashkinë e Tiranës
5. Në Ministrinë e Bujqësisë
6. Takim me Ministrin Z. Bledi Çuçi
7. Muaji i Artit dhe Letërsisë
8. Konkurse
9. Panairi i Librit
10. Unë lexoj...
11. Klipi i 28-29 Nëntorit
12. Koncerti i Festave të Nëntorit
13. Dhurojmë libra dhe Shqipëria bëhet më e mire
14. Letër vetes sime 35-vjeçare
15. Mos ma prek Valbonën!
16. Çfarë bëj unë për atdheun...
17. Klubi "Shpresa" në Tangram
18. Media të jetë më e mire
19. Parapërgatitje për Olimpiadat
20. ASEF
21. Olimpiada e matematikës
22. GDS 1
23. OPT
24. Kampionati i gjashtë i lojërave të inteligjencës
25. Në mbrojtje të Ozonit
26. Një ditë pa makina
27. Klubi i fotografisë
28. Klubi i gatimit
29. Piknik në Pezë
30. Fundjavë në Llogara
31. Ekskursioni në Shkodër
32. Shkolla dimërore në Londër
33. Shëtitje në Kroaci
34. Vizitë në Top Channel
35. Në TEG
36. Brenda Muzeut të Parave
37. Stacioni Meteorologjik
38. Ekipi i hendbollit
39. Finalja e kampionatit të futbollit
40. Edukimi i vlerave
41. Ora e Lojës
42. Te Liqeni
43. Kopshti Zoologjik
44. Në bibliotekë
45. Fizikultura e mungjesit
46. Festojmë ditëlindjet me prindërit
47. Higjiena dhe shëndeti
48. Vizitë në Muzeun Historik Kombëtar
49. Vizita në shtëpi

Klubi Shpresa

Klubi Shpresa e filloi aktivitetin e tij këtë vit që në muajin tetor ku u përcaktuan objektivat për vitin akademik 2016-2017.

Secila klasë u përfaqësua nga dy nxënës.

Konkretisht u planifikuan të bëhen së paku 8 aktivitete, të cilat synojnë mbledhjen e ndihmave financiare nga nxënësit dhe shpërndarjen e tyre në fshatra dhe jetimore.



Panairi Ushqimor

Panairi Ushqimor solli gjatë nëntorit dhjetë ditë të mbushura me aromë, shije dhe traditë gatimesh nga të gjitha trevat e vendit, pas të cilave qëndron mbledhja e të hollave për të blerë ushqime bazë, që do të paketohen dhe do të shpërndahen nga anëtarët e klubit "Shpresa" te familjet në nevojë.



KLUBI SHPRESA



KLUBI SHPRESA

- “Fundjavë Ndryshe” - nxënësit e klasave 7G, 8D dhe 8G kontribuan për familjet në nevojë me ushqime dhe veshmbathje, të cilat i çuan vetë pranë këtyre familjeve.

- “Klubi i Mëngjesit” - nxënësit e klasës 8E u bënë pjesë e “Maratonës”, organizuar në Club FM, për të mbledhur libra, lodra e veshje për fëmijët dhe familjet në nevojë.

- Klubi “Shpresa” - nxënësit e klasës 8F përgatitën pako me mjete mësimore, të cilat ua dhuruan bashkëmoshatarëve të tyre në shkollën “1 Qershor”, në prag të festave të fundvitit.



DISA VEPRIMTARI





Nga veprimtaritë e Klubit "Shpresa"

- Nxënësit e klasave të 5-ta shpërndanë ndihma ushqimore te familjet e përmbytura në Fushë-Krujë.
- Nxënësit e klasave të 6-ta shpërndanë ndihma ushqimore te Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Nxënësit e klasave të 9-ta shpërndanë ndihma ushqimore te shkolla "Dhora Leka", Tiranë.
- Përfaqësues të klubit shpërndanë ndihma ushqimore te familjet në nevojë në Tiranë.





Në Bashkinë e Tiranës

Gjatë tetorit, nxënësit e klasave 5G dhe 5F vizituan Bashkinë e Tiranës. Ata takuan kryetarin e saj, Z. Erion Veliaj për të biseduar rreth një projekti, i cili lidhet si me fushatën Kombëtare të Leximit, ashtu dhe me Muajin e Artit dhe Letërsisë që zhvillohet në shkollën tonë.

Ky projekt ka si qëllim dhurimin e librave për fëmijë të grumbulluar nga vetë nxënësit. Z. Veliaj shprehu kënaqësi dhe vlerësim për këtë iniciativë.

Nxënësit e shkollës "Turgut Özal" grumbulluan afërsisht 900 libra për fëmijë, të cilët do të shpërndahen në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.



VIZITA NË INSTITUCIONE





Në Ministrinë e Bujqësisë

Shkolla jonë u bë pjesë e aktivitetit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në kuadër të “Muajit të Bujqësisë”. Drejtuesit e shkollës së bashku me dy grupet e Klubeve të Gatimit dhe nxënësit e klasave të katërta u pritën nga Ministri, Z. Edmond Panariti. Gjatë aktivitetit, i cili titullohej “Bujqësia në sytë e fëmijëve”, Ministri i këshilloi fëmijët që të ushqehen në mënyrë sa më të shëndetshme dhe shprehu idenë se kultura e ushqimit, ndoshta duhet të jetë dhe lëndë mësimore në shkolla.



VIZITA NË INSTITUCIONE





Takim me Ministrin Z.Bledi Çuçi

Nxënësit tanë u mirëpritën nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, në zyrën e tij. Atje zhvilluan një bisedë të ngrohtë e frytdhënëse dhe patën rast të diskutonin, jo vetëm për rolin mjaft të rëndësishëm të këtij institucioni, por edhe të shprehnin dëshirat personale në lidhje me shkollën dhe të ardhmen e tyre. Pas takimit me ministrin, ata u shoqëruan për të parë nga afër ambientet e Kryeministrit dhe vepra të autorëve të ndryshëm të ekspozuara në ambientet e saj apo sallat e mbledhjeve, ku ngjarje e detaje kulturore rrëfeshin nga një ciceron.



VIZITA NË INSTITUCIONE



Muaji i Artit dhe Letërsisë



Tetori shënoi hapjen e siparit të Muajit të Letërsisë. Projekte të veçanta e krijuese erdhën si fryt i punës së palodhur të nxënësve. Ata mbushën çdo cep të shkollës duke i dhënë një frymë atdhetare. Gjatë këtij muaji u zhvilluan aktivitete dhe konkurse, ku nxënësit e talentuar, shpalosën aftësitë e tyre, në atmosferën e garës dhe kënaqësisë, por natyrisht dhe me ethet e fitores.

Motoja e këtij muaji ishte "Sot një fëmijë që lexon, nesër një i rritur që mendon."



MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Konkurse

Në dhjetor u zhvillua në ambientet e kolegjit "Turgut Özal" Tiranë faza finale e Konkursit të Këngës, Interpretimit, Krijimit dhe Pikturës, ndërsa në ambientet e kolegjit "Turgut Özal" Durrës, finalja e Artit Skenik.

Finalistët e "Turgut Özal" Tiranë, "Turgut Özal" Durrës, "Hasan Riza Pasha" Shkodër, "Mehmet Akif" (vajza), "Mehmet Akif" (djem) dhe MIST u përballën në një garë të fortë mes njëri-tjetrit.

Anëtarët e jurisë për Këngën ishin: Xhovalin Lazri, Alma Strazimiri dhe Edlira Gjoni.

Në jurinë e Interpretimit ishin: Alfred Trebicka, Violeta Trebicka, Rozi Kostani, Erjona Kakeli.

Më e qetë ishte atmosfera në sallat ku zhvillohej Konkursi i Kompozicionit dhe ai i Pikturës. Ndërsa në Durrës, skena e teatrit të shkollës ndërroi krejtësisht pamjen e saj nën interpretimet e disa prej pjesëve më të bukura teatrale si: "Mbreti Lir", "Cuca e maleve", "Përrallë nga e kaluara", "Borgjezi fisnik", "I sëmuri për mend" etj.

Në jurinë e Artit Skenik ishin: Mimoza Marjanaku, Edmond Halili, Marvin Tafaj, Xhejni Fama, Era Çaushti, Elios Ibro.

Panairi i Librit

Panairi i 19-të i Librit, Tirana 2016, i hapur në Pallatin e Kongreseve në datat 9-13 nëntor, u vizitua dhe nga nxënësit e shkollës sonë, të cilët nuk i shpëtuan dot tundimit për të blerë librat më të fundit të dalë në qarkullim. Ky Panair, si ngjarja më e madhe kulturore në pasqyrimin e veprimtarisë letrare brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, përbën gjithmonë një vendtakim mjaft të lakmuar të lexuesit me librin.



MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Unë lexoj...

Leximi i librit jashtëshkollor është një traditë e bukur në shkollën tonë prej shumë vitesh. Për më tepër gjatë muajit tetor, Muajit të Artit dhe të Letërsisë dhe në vijim të nismës "Unë lexoj", nxënësit e klasave të ndryshme, orën e leximit e zhvilluan në ambientet e këndshme të bibliotekës së shkollës. Kjo është një mënyrë që nxënësit të shtojnë takimin me librin dhe dashurinë për leximin në bibliotekë.





FESTAT E NËNTORIT

Klipi i 28-29 Nëntorit

Me rastin e festave të 28 -29 Nëntorit nga nxënësit e shkollës sonë u përgatit një video gjatë së cilës u shpalosën në të gjitha ambientet e shkollës ngjyrat e flamurit tonë kombëtar, simbolet tona kombëtare si dhe veshje të ndryshme popullore.



FESTAT E NËNTORIT

Koncerti i Festave të Nëntorit

Festat e 28 dhe 29 Nëntorit, jehuan sërish madhërishtëm në shkollën tonë në tre koncerte festive. Vargjet dedikuar Atdheut, këngët, vallet e kostumet popullore me ngjyrat e trevave të ndryshme të Shqipërisë, të shpalosura mes lëvizjeve plot elegancë të valltarëve të vegjël, përcollën emocione pa fund te pjesëmarrësit.

Në konkursin e projekteve "Tangram" zhvilluar nga televizioni Ora News, me qëllim nxitjen e fëmijëve për të menduar se si Shqipëria mund të bëhet më e mirë, morën pjesë edhe 6 nxënës nga shkolla jonë.

Dhurojmë libra dhe Shqipëria bëhet më e mirë

Meliora Veliaj, nxënëse e klasës 5G, prezantoi projektin e klasës për të dhuruar libra të bashkëmoshatarët e tyre. Ekipi i xhirimit të Ora News filmoi çdo hap të zbatimit të projektit teksa nxënësit dhuronin libra në shkollat "Hillary Klinton" në Kamëz, "Pal Engjëlli" në Tufinë dhe "Lasgush Poradeci" në Kombinat. Nxënësit pritës, drejtuesit dhe përfaqësuesit e bashkisë së qytetit e falenderuan Meliorën dhe shokët e klasës së saj për këto dhuratë me kaq shumë vlerë për bibliotekat e këtyre shkollave.



Letër vetes sime 35-vjeçare

Vivien Shkodra, nxënëse e klasës së 7H, lexoi letrën që i kishte drejtuar vetes, në të cilën ajo shprehte dëshirat dhe ëndrrat e saj për të ardhmen. Xhirimet për projektin u zhvilluan në ambientet e shkollës dhe në bazë të skenarit ishte Vivien tek shfaqej si vajza në klasë të shtatë duke shkruar letrën dhe më pas, në moshën 35-vjeçare, duke e lexuar atë e duke kujtuar dëshirat dhe këshillat, që i pati dhënë vetes shumë vite më parë.

Mos ma prek Valbonën!

Klara Morina, nxënëse e klasës 8A nëpërmjet projektit të saj synoi ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e pasurisë natyrore që përfaqëson Valbonën. Sipas Klarës, Shqipëria do të jetë më e mirë nëse Lumi i Valbonës nuk shfrytëzohet nga dora e njeriut për hidrocentrale. Ajo e krahason këtë bukuri natyrore me bukuri të njohura të vendeve të huaja dhe thekson se turizmi mjafton si shfrytëzim për të rritur mirëqënien e banorëve të kësaj zone.



Çfarë bëj unë për atdheun...

Mea Tela, nxënëse e klasës 5G, konkurroi me projektin e saj "Mos pyet se çfarë bën atdheu për ty, por pyet veten se çfarë bën ti për atdheun". Mea thekson në projektin e saj se ne e bëjmë më të mirë vendin tonë duke filluar që nga respektimi i rregullave në rrugë, në park, në ambiente publike, e duke vazhduar me zgjedhjen e drejtuesve në bazë të vlerave dhe meritave. Në projektin e saj Mea beson dhe inkurajon edhe të tjerët që Shqipëria MUND të bëhet dhe NE duhet ta bëjmë atë.

Klubi "Shpresa"

Sara Xholi, nxënëse e klasës së 8D, prezantoi projektin e saj të titulluar "Shqipëria më e mirë, kur njerëzit mësojnë të japin më shumë."

Sara shpjegoi rëndësinë që kanë nismat e Klubit "Shpresa" të shkollës sonë në ndihmë të njerëzve në nevojë.

Prezantimi i Sarës u xhirua teksa Klubi "Shpresa" ndihmoi me ushqime të mbledhura nga nxënësit e shkollës sonë, Shoqatën Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara "Shpresa për jetën".



Media të jetë më e mirë

Engjellushë Basha, nxënëse e klasës 7D, mori pjesë me projektin "Shqipëria më e mirë, kur media të jetë më e mirë". Si anëtare e klubit të medias të shkollës sonë, ajo merr pjesë në shkrimet e gazetës së shkollës dhe është në fillimet e mbara të gazetarisë. Në projektin e saj Engjellushja, si një gazetare e vërtetë, parashtrroi hapat që duhet të ndjekë një gazetar për vërtetësinë e lajmit, si dhe rëndësinë që ka paanshmëria dhe etika në profesionin e tij.



LISTA E PROFILEVE
PROFILES LIST



CE 70 000



CE 60 000



CE 50 000



Parapërgatitje për Olimpiadat

Olimpiadat zhvillohen gjatë periudhës së dytë të vitit shkollor në universitetin "Epoka", ku marrin pjesë nxënësit finalistë nga shkollat "Turgut Özal", "Mehmet Akif", "MIST" dhe "Hasan Riza Pasha". Shkolla jonë që prej javëve të para të shkollës ka nisur përgatitjet me afërsisht 200 nxënës nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, të cilët janë përzgjedhur në bazë të prirjeve dhe testeve eliminuese në matematikë, fizikë, biologji, kimi, kompjuter, anglisht dhe turqisht.



VEPRIMTARI SHKENCORE

Parapërgatitje për ASEF

Kanë filluar përgatitjet për Olimpiadën e Projekteve ASEF 2017. Nxënësit regjistrojnë projektet e tyre dhe krijojnë grupet e punës. Nxënësit do konkurrojnë në dy kategori: senior dhe junior. Kategoritë, si çdo vit, janë: Poster design, Short movie, Web dizajn, Programim dhe Shkencë.

Risia e këtij viti është shtimi i një kategorie shumë tërheqëse, projektimi industrial.

OLIMPIADA E MATEMATIKËS

Olimpiada Kombëtare e Matematikës për klasat e nënta përfundoi me sukses fazën e saj të dytë. Katër vendet e para të saj janë fituar nga katër nxënës të klasës së 9-të të shkollës sonë.



VEPRIMTARI SHKENCORE

Nxënësit fitues janë:

David Selba	vend i parë	45 pikë
Heidi Duresi	vend i dytë	44 pikë
Bjorna Permeti	vend i tretë	39 pikë
Ingis Beliu	vend i katërt	38 pikë



Bora e parë në oborrin e shkollës pas 7 vitesh, 2017



GDS 1

Në dhjetor u zhvilluan GDS-të për periudhën e parë të vitit shkollor. Me anën e këtyre testeve, drejtoria e shkollës dhe mësuesit matin njohuritë e marra nga nxënësit për periudhën shtator-nëntor. Këtë vit, në ciklin fillor testohen online të gjitha lëndët, ndërsa në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare testohen online një pjesë e tyre, si: histori, gjeografi, gjuhë shqipe dhe anglisht.



VEPRIMTARI SHKENCORE

OPT - Oxford Placement Test

Si çdo vit edhe këtë tetor u zhvilluan testet online të nivelit të anglishtes për nxënësit e klasave të 3-ta, të 4-ta dhe të 5-ta. Ky lloj testi është një matës i njohurive dhe përcakton nivelin e nxënësve në gjuhën angleze. Përgjigjet e këtij testi janë të menjëhershme dhe nxënësit mund të shohin në kohë reale se cilit nivel i përkasin ata.



LOJËRAT E INTELIGJENCËS

Kampionati i gjashtë i lojërave të inteligjencës

Shpeshherë jemi mësuar të matim inteligjencën tonë përmes aftësive që kemi për të qenë të parët në lojëra të tilla si shahu apo sudoku, por jo më pak zbavitëse dhe stimuluese janë edhe disa të tjera që tingëlllojnë të padëgjueshme e të çuditshme, si jenga, mangala, kakuzu, hanoi, reversi, scrabble, 9 tas etj. Në vazhdim të kampionateve të lojërave të inteligjencës, pjesë e këtyre sfidave janë bërë edhe nxënësit tanë.

Fituesit e vendeve të para janë: Ami Hoxha 6F në jenga dhe Klevis Lleshi 9C në mangala. Fituesit e vendeve të dyta janë: Merjem Daja 4E dhe Henri Olldashi 8F në jenga dhe Klei Hysaj 8F në shah. Ndërsa fituesit e vendeve të treta janë: Berke Ustundag 6D dhe Marin Shpata 8F në jenga dhe Arkid Kaleci 9B në shah.

TË MBROJMË MJEDISIN

Në mbrojtje të Ozonit

Përmbyllja e veprimtarive për Ditën e Ozonit solli në shkollën tonë vizitorë nga Ministria e Mjedisit si dhe Njësia Kombëtare e Ozonit.

Në mbyllje të konkursit të zhvilluar, përfaqësuesit e këtyre institucioneve u shprehën të entuziazmuar nga njohuritë e nxënësve tanë në lidhje me veprimet që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e Ozonit.

Përfaqësuesja e Njesisë Kombëtare të Ozonit në përshëndetjen e saj u shpreh se "Nxënësit janë ata, që do të hedhin themelet e një bote më të shëndetshme."



Një ditë pa makina

Në shtator, nxënësit e klasës së 7C morën pjesë në aktivitetin "Një ditë pa makina", organizuar nga Bashkia e Tiranës. Në orët e para të mëngjesit nxënësit u nisën në drejtim të sheshit "Nënë Tereza". Me shkumësa me ngjyra ata vizatuan në korsinë e biçikletave se si e përfytyrojnë qytetin e tyre. Më pas u bashkuan me grupet e tjera që ishin pjesëmarrëse në këtë aktivitet. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj, bashkëbisedoi me nxënësit dhe i përgëzoi ata për punën e tyre.

Klubi i fotografisë

Klubi i fotografisë është një nga më interesantët. Ai është hapur rishtazi këtë vit dhe përmes tij nxënësit mësojnë të kapin në objektiv momentin duke u argëtuar dhe duke shëtitur.

Programi i këtij klubi është mjaft i larmishëm. Ai fillon me mësimin e teknikave të fotografisë si fillim, pastaj kalohet në gjinitë e fotografisë e më tej tek ekspozita që do të zhvillohet dhe aktivitete të tjera surprizë, nga organizatorët.

**KLUBET****Klubi i gatimit**

Pasioni për gatimin ka mbledhur rreth tryezës së kuzhinës së klubit tonë disa nga nxënësit e shkollës. Së bashku me mësueset, që janë pjesë e klubit, ata realizojnë gatime nga më të shumëllojshmet. Që recetat e përgatitura të mos harrohen, fëmijët i praktikojnë në shtëpi, duke kënaqur kështu edhe shijet e familjarëve të tyre.

Disa receta të gatuar deri tani janë: torta me biskota, kabunia, krepas, strudeli, zupat, apo makaronat me pana dhe fileto pule, ku dhanë ndihmën e tyre edhe drejtues të shkollës.

Si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore, nxënësit ishin të ftuar në pastiçerinë "Lej & Laj".

SHËTITJET



Piknik në Pezë

Nxënësit e klasave të para, të katërta dhe të pesta shkuan në piknik në Pezë. Edhe pse moti ishte me vranësira, natyra ofroi pamje të bukura dhe plot mundësi argëtimi. Në fytyrat e nxënësve mund të dalloje lumturi, hare dhe emocion teksa shijonin ngjyrat e larmishme që të ofron vjeshta. Në fushë fëmijët luajtën lojëra të ndryshme me top, bënë gara vrapimi, ndeshje ndërmjet klasave, luajtën me litar dhe mblodhën gjethe për herbariume. Në fund, nxënësit grumbulluan letrat e hedhura shkujdesur gjatë piknikut, duke e lënë fushën të pastër.

Fundjavë në Llogara

Shumë prej nxënësve tanë, nga paralele të ndryshme, këtë vit kanë preferuar të vizitojnë Llogaranë. Itinerari niste me bisedat dhe shakatë gjatë rrugës, lojërat e ndryshme dhe më pas një pushim i vogël për drekë në qytetin bregdetar të Vlorës.

Mbërritja në destinacion ishte emocionuese dhe e shoqëruar me thirrjet e gëzimit të nxënësve. Akomodimi i tyre në kabinat malore ndiqej nga shëtitja në këmbë nëpër Parkun e Llogarasë dhe ngjitja në Qafën e Cezarit. Pasditet ofronin pushim në pishinën e hotelit dhe në ambientet sportive.



Ekskursioni në Shkodër

Gjatë tetorit nxënësit e klasave të 8-ta vizituan kalanë e Rozafës, simbolin e qytetit të bukur të Shkodrës. Madhështia dhe lashtësia e kalasë, bukuria e saj, si dhe muzeu brenda saj u fiksuan në fotot e shkrepura dhe pozat e shumta. Dreka u shijua në një restorant tradicional, i cili ndodhej buzë lumit Buna, nga ku u sodit edhe bukuria që i fal lumi këtij qyteti.

SHËTITJET

Shkolla

dimërore në Londër

Shkolla dimërore në Londër me nxënësit e klasave të 6-ta, të 7-ta dhe të 8-ta, ishte një mundësi për të përjetuar jetën e një nxënësi të këtij qyteti europian. Gjatë paraditeve u zhvilluan orë mësimore nga mësues vendas, ndërsa pasditeve dhe mbrëmjeve shëtitej nëpër qytet pranë pikave turistike, si: Big Ben, Hyde Park, London Bridge, London Eye, Tower Bridge, Trafalgar Square, Buckingham Palace, Westminster dhe Royal London, Natural History Museum, Arsenal Stadium, etj. Argëtim më vete përbënë edhe London City tour dhe shëtitja me traget në lumin Tamiz.

Gjithashtu, vend të veçantë zuri shëtitja në Woburn Safari Park si dhe vizita në qytetin e vjetër të dijes, Oxford City dhe Oxford University.



Shëtitje në Kroaci

Një fundjavë ndryshe nga të tjerat priste klasat e katërta e të pesta teksa u nisën drejt Kroacisë. Nata e parë kaloi në një hotel të këndshëm në Split me ushqim të mirë dhe pushim të rehatshëm. Të nesërmen, udhëtimi që i gjatë, por rezervoi bukurinë e disa peizazheve të rralla buzë liqeneve të Plitvicës.

Edhe ndalesa në qytetin e vjetër të Dubrovnikut, u la nxënësve shumë mbresa me muret rrethuese antike, monumentet e shumta, shëtitorët, kështjellat mesjetare dhe bregdetin përrallor. Teksa shijonin akulloret tradicionale vendase, ata blinin edhe suvenire, si për të marrë me vete një pjesë nga ky qytet i mrekullueshëm.



SHËTITJET

Vizitë në Top Channel

Klasa e 6B vizitoi disa nga skenat më të famshme të televizionit Top Chanel. Nxënësit shëtitën nëpër studiot ku realizohen formatet e njohura "Top Show", "Fiks Fare", "Pa limit", "The Voice" etj.

Më pas, ndoqën provat e programit humoristik "Portokalli" dhe bënë foto me aktorët e tij të njohur, por gjëja që u la përshtypje më shumë ishte numri madh i stafit që punonte pas kuintave për t'i bërë këto programe të kenë një audiencë sa më të gjerë.



Në TEG

Një nga aktivitetet e zhvilluara me nxënës të paraleleve të ndryshme ishte dhe vizita në qendrën tregtare TEG. Edhe pse nxënësit e njohin këtë qendër dhe e vizitojnë me familjarët e tyre, vizita me shokët e shoqet e klasës është përherë e shumëpritur.

Nxënësit shkuan edhe në kinemanë Cineplex të kësaj qendre ku panë një film të animuar 3D për fëmijë.

SHËTITJET

Brenda
Muzeut të Parave

Klasat e 4D dhe e 8B vizituan Muzeun e Parave, pjesë e Bankës Qendrore të Shqipërisë.

Përgjegjësjë e Muzeut, Besa Praela, i shoqëroi dhe i informoi nxënësit tanë mbi historikun e monedhave të shtypura dhe të qarkulluara në vendin tonë përgjatë dy mijë vjetësh dhe mbi valutën shqiptare ndër shekuj. Në dhomën e thesarit fëmijët u befasuan nga një lingotë e artë me peshë 12.4 kilogramë, e cila përfaqëson pamjen maksimale të parasë. Më tej, ata me kuriozitet soditën koleksione të stolive të grave nga vise të ndryshme të Shqipërisë, të zbukuruar me monedha ari dhe argjendi. Shumë interes ngjalli edhe dhoma e Hologramit, në të cilën shfaqej një rrëfenjë monedhash antike, e projektuar në hapësirë, në 3 dimensione 360 gradë.

**Stacioni**
Meteorologjik

Stacioni meteorologjik u vizitua nga nxënësit e klasës 4G. Gjatë kësaj vizite nxënësit panë nga afër disa mjete, të cilat matin dukuritë atmosferike, si: higrometri për matjen e lagështisë, barometri për matjen e shtypjes atmosferike, pluviometri-për matjen e sasisë së reshjeve.

AKTIVITETET SPORTIVE



Ekipi i hendbollit

Këtë vit shkolla "Turgut Özal" në bashkëpunim me Federatën Kombëtare të Hendbollit formoi dy ekipe hendbolli, për vajza dhe djem, të cilët përfaqësuan shkollën në ndeshjet brenda Tiranës dhe jashtë saj. Ekipi i djemve e zhvilloi kampionatin e tij të parë në qytetin e Elbasanit, ndërsa ekipi i vajzave e zhvilloi kampionatin e parë në palestrat e mbyllura të shkollës sonë. Të dyja ekipet u renditën në vendin e tretë.



Finalja e kampionatit të futbollit


Kampionati i futbollit për klasat e katërta e të pesta u zhvillua me sistem eliminimi. Ndeshjet u bënë gjatë orëve të mësimit të edukimit fizik, ndërsa gjysmëfinalet dhe finalja në pushimin e gjatë. Spektatorë ishin prindërit, mësuesit dhe nëndrejtorët përkatës. Mes klasave pati rivalitet dhe luftë sportive.

Për klasat e katërta, në gjysmëfinale dolën e 4A dhe e 4F. Kupa u fitua nga klasa e 4F. Tek klasat e pesta, gjysmëfinalja u luajt mes klasave e 5B dhe e 5D, ku fituese u shpall klasa e 5B.

C.A.E. sh.p.k.



“Ne ndërtojmë atë që të tjerët ëndërrojnë”



Banka e Shqipërisë

Është një projekt shumë i rëndësishëm dhe ambicioz. Në këtë projekt C.A.E. sh.p.k është kontraktor i parë së bashku me shoqërinë ACMAR s.c.p.a. Puna që është kryer është rikonstruksioni i godinës ekzistuese dhe ndërtimi i kompleksit të ri të Bankës së Shqipërisë.

Vlera e kontratës është prej 15 milion Euro.

Edukimi i vlerave

Shkolla është vendi ku brumosen vlera që i shërbejnë njeriut gjatë gjithë jetës. Pikërisht, për edukimin e këtyre vlerave njerëzore, si: humanizmi, mirësjellja, altruizmi, kujdesi për veten dhe shëndetin vetjak, me fëmijët e parashkollorit dhe të klasave 1-3 organizohen aktivitete të veçanta praktike.

Fëmijët kanë kryer veprimtari si: larja e dhëmbëve, larja e duarve, vizita te mjeku i shkollës, vëzhgimi se sa mikrobe ka rreth nesh, përdorimi i fjalëve “magjike”, mirësjellja në klasë dhe në ambiente publike etj. Këto veprimtari praktike shoqërohen edhe me prezantime videosh apo filmash për fëmijë.



Ora e Lojës

Vogëlushët e parashkollorit kanë çdo ditë orën e tyre të lojës, të cilën e zhvillojnë në Sallën e Lojërave, që ndodhet brenda ambienteve të kopshtit, ose në Këndin e Lojërave, që është vendosur në oborrin e kompleksit. Lojërat lëvizore luajnë një rol të madh për zhvillimin psiko-motor të fëmijëve, prandaj lojërat që organizohen nga edukatorët janë në favor të zhvillimit fizik, social dhe emocional të fëmijëve.

Loja është aq e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës, sa ajo është njohur nga Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut si një e drejtë e çdo fëmije.

Te Liqeni

Ku ka më bukur se pylli në vjeshtë! Ngjyrat e larmishme të gjetheve, freskia dhe ajri i pastër i ftuan vogëlushët e grupit të tretë të parashkollorit të kalonin një ditë ndryshe në kodrat e liqenit artificial. Ata, gjithashtu, u argëtuan te këndi i ri i lojërave që është ngritur pranë liqenit. Edhe pse të vegjël, ata respektuan hapësirën e gjelbër të parkut dhe njëkohësisht shijuan orët e lojës me njëri-tjetrin në këndin e ri.



Kopshti Zoologjik

Fëmijët i duan kafshët dhe vizita në Kopshtin Zoologjik është një mundësi e mirë për të parë nga afër kafshë e shpendë, të cilat i kanë parë vetëm nëpër filma ose i kanë dëgjuar nëpër përralla.

Fëmijët panë disa lloje kafshësh e shpendësh, por më së shumti u argëtuan kur panë rosat dhe mjelmat teksa notonin në ujin e liqenit. Në fillim u përpoqën t'i afronin shpendët duke u thirrur, por më pas filluan t'u hidhnin ushqim dhe sytë e tyre shkëlqyen nga gëzimi kur shpendët e bukur të liqenit u afruan pranë fëmijëve.

Në bibliotekë

Sa më e hershme të jetë lidhja me librin, aq më e fortë dhe e qëndrueshme do të jetë ajo gjatë jetës. Për këtë arsye, fëmijët e parashkollorit i zhvillojnë një pjesë të temave mësimore në bibliotekën e shkollës. Të tërhequr nga figurat dhe ngjyrat ata shpesh rrëmbejnë një libër dhe ulen e "lexojnë" vetë duke krijuar histori të reja bazuar në pamjet e dhëna. Nga sytë kureshtarë dallohet që mezi presin çastin kur vërtet do lexojnë historitë që shkruhen nëpër libra.



Fizkultura e mëngjesit

Çdo mëngjes vogëlushët e parashkollorit sipas grupeve përkatëse dalin në oborrin e shkollës apo te fushat e sportit. Ata, së bashku me edukatoren e grupit, zhvillojnë ushtrime dhe aktivitete fizike për rreth 20-30 minuta. Edhe nëse moti në mëngjes është i ftohtë dhe maja e hundës apo faqet e tyre skuqen paksa, ata vazhdojnë të dalin me dëshirë dhe t'i shfrytëzojnë me gëzim e gjallëri këto minuta. Pas fizkulturës së mëngjesit, fytyrat e tyre janë më të qeshura dhe ata ndihen më të gjallë për veprimtaritë që i presin gjatë ditës.

Festojmë ditëlindjet me prindërit

Vogëlushët e parashkollorit i festojnë ditëlindjet në ambientet e kompleksit tonë arsimor dhe krahas shokëve dhe shoqeve, ftojnë edhe prindërit dhe të afërmit e tyre. Kështu festa e ditëlindjes bëhet më e plotë dhe fëmijët ndiejnë njëkohësisht si praninë e familjarëve, ashtu edhe të shoqërisë së tyre. Shpeshherë këto ditëlindje pasurohen me pjesëmarrjen e gaztorëve, muzikantëve për fëmijë, këngëve, tullumbaceve shumëngjyrëshe, lojërave argëtuese dhe ëmbëlsirave aq shumë të dëshirueshme për vogëlushët, duke krijuar një atmosferë të vërtetë festive.



Higjiena dhe shëndeti

Vogëlushët e parashkollorit zhvillojnë një sërë veprimtarish për edukimin e shprehive lidhur me higjienën personale dhe shëndetin. Çdo dy javë ka një temë ndryshe dhe aktivitete që zhvillohen në lidhje me të. Deri tani janë zhvilluar veprimtari në lidhje me larjen e duarve, larjen e dhëmbëve, mbajtjen pastër të trupit, rregullimin e dhomës dhe çantës. Disa nga grupet e parashkollorit kanë zhvilluar edhe vizita te dentisti për të kontrolluar dhëmbët e tyre.

Vizitë në Muzeun Historik Kombëtar

Edhe pse ende të vegjël për të kuptuar historinë mijërvjeçare të popullit tonë fëmijët e parashkollorit panë të mahnitur Pavionin e Lashtësisë, ndoqën me sy kureshtarë Pavionin e Mesjetës dhe brohoritën te Pavioni i Pavarësisë. Me hapa të vegjël e të shkathët ndiqnin ciceronin dhe dëgjonin me vëmendje çdo fjalë të tij. Herë pas here bënë edhe pyetje për disa nga figurat e shquara historike që shihnin të ekspozuara në kënde të ndryshme të pavioneve. Ne të rriturve na la mjaft mbresa dëshira dhe kurioziteti i fëmijëve gjatë gjithë vizitës në Muzeun Historik Kombëtar.



Vizita në shtëpi

Një nga aktivitetet më miqësore dhe dashamirëse, të organizuara nga grupet e dyta dhe të treta të parashkollorit gjatë muajve shtator-dhjetor, ishin vizitat në familjet e shokëve të grupit. Ishin emocione të veçanta ato që provonin fëmijët mikpritës teksa shikonin në shtëpinë e tyre të gjithë shokët dhe shoqet e grupit bashkë me edukatoren. Ndrotja dhe turpi i minutave të para shumë shpejt i linin vendin entuziazmit dhe kënaqësisë që edhe në shtëpi mund të luaje me shokët po njësoj si në kopshtin e dashur. Në këto takime nuk munguan gatimet e shijshme dhe dhuratat për vogëlushët mysafirë.

SPORT VISION



SPORT  VISION SPORT  VISION SPORT  VISION SPORT  VISION SPORT  VISION SPORT  VISION

TEG
Be happy

QTU

 **TOPTANI**
SHOPPING CENTER

M.SHYRI SHKODËR VLORE



Sill kuponin dhe FITO

20% ULJE

NË KOLEKSIONIN E RI



Sport Vision Albania



sportvisionalbania



www.sportvision.al



K O L E G J I
T U R G U T Ö Z A L

....Ne ndërtojmë të ardhmen tuaj....



KONSTRUKSION
IANTE



Rr.Frostina Plaku.Pall.21 ap1/27 Tiranë
Tel/fax: +355 4 235 802
Mob: +355 6920 65949

www.viante.al
E-mail:viantekonstruksion@yahoo.com
E-mail:info@viante.al



www.uspolo.al



U.S. POLO ASSN. SINCE 1890

Ekskluzivisht në

M. SHYRI

TEG

Citypark

RING
TIRANA RING CENTER

TOPTANI
SHOPPING CENTER